



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

V E N D I M

Nr. 44, Datë 10/04/2014

Pasi u njoh me ankesën nr. 3, datë 13.01.2014 dhe ankesën nr. 10, datë 05.02.2014, të shtetasit
Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I :

Mbështetur në nenin 32, pika 1, gërma a), të ligjit nr.10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, është paraqitur ankesa nr.3, datë 13.01.2014, e Z. , ku pretendohet për diskriminim të tij për shkak të racës, nga ana e Filialit të Postës Elbasan.

Sipas shpjegimeve të dhëna në ankesë, Z. pretendon se ai është diskriminuar, sepse nëpërmjet Urdhërit nr. 25, datë 09.01.2014, të Drejtores së Filialit të Postës Elbasan, ai është transferuar nga pozicioni “shpërndarës” pranë Filialit të Postës Elbasan, në pozicionin “agjent” pranë Zyrës Postare Stravaj Librazhd. Ankuesi nuk ka qenë dakord me këtë transferim dhe është i bindur, se ky është një veprim diskriminues i ndërmarrë ndaj tij, për shkak se ai i përket komunitetit rom.

Ankuesi ka depozituar pranë KMD-së brenda pak javëve nga ankesa e parë, një ankesë të dytë kundër Filialit të Postës Elbasan. Sipas kësaj ankese, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi bëhet me dije se, Z. është liruar nga detyra dhe i janë ndërprerë marrëdhëniet financiare. Sipas tij, shkaku i vërtetë i largimit të tij nga puna është përkatësia në komunitetin rom.

Për sa më sipër, hapat proceduralë të ndjekur nga strukturat përkatëse të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, paraqiten si më poshtë vijojnë :

1. Pas analizimit të ankesës nr. 3, datë 13.01.2014 dhe ankesës nr. 10, datë 05.02.2014, të Z. [] u konstatua se nga pikëpamja formale, ato i plotësonin kërkesat e parashikuara nga neni 33, pika 3 të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi". Për këtë arsye, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi filloi procedurat përkatëse për shqyrtimin e tyre. Fillimisht, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi filloi hetimin e ankesës nr. 3, datë 13.01.2014. Pas paraqitjes së ankesës nr. 10, datë 05.02.2014, ato u trajtuan së bashku duke dalë në fund me një vendim të përbashkët, meqënëse të dy ankesat ishin të dërguara nga i njëjti ankues, kundër të njëjtit subjekt dhe me objekt pothuajse të njëjtë.

2. Mbështetur në nenin¹ 33, pika 7, të ligjit nr. 10 221/2010 "Për mbrojtjen nga diskriminimi", Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi iu drejtua Drejtoreshës së Filialit të Postës Elbasan, me shkresën nr. 33/1, datë 20.01.2014, ku kërkohej informacion, lidhur me çështjen e ankuesit []

- Për sa më sipër, me shkresën nr.142, datë 29.01.2013, të Filialit të Postës Elbasan, Drejtoresha e këtij Filiali, informon Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi, lidhur me ankesën e Z. []

Znj. [] informon se në bazë të kontratës individuale të punës që Z. [] ka lidhur me Filialin e Postës Elbasan, parashikohet se në rast të thyerjes së disiplinës në punë, dëmtimit të rëndë e të përsëritur të pasurisë së shoqërisë, mospërbushjes së detyrës në kohë, cilësi dhe efektivitet etj. punëmarrësi mund të marrë masa disiplinore. Nga dosja personale e punonjësit rezultonte se :

- Me shkresën nr. 542, datë 04.07.2012, punonjësi ka marrë një masë disiplinore "vërejtje me paralajmërim për largim nga detyra".
- Me shkresën nr. 999, datë 17.12.2012, punonjësi ka marrë masë disiplinore "vërejtje me shkrim".
- Me shkresën nr. 820, datë 29.10.2013, punonjësi ka marrë masë disiplinore "vërejtje me paralajmërim për largim nga puna".

Me Vendimin nr. 25, datë 09.01.2014 të Drejtorisë së Filialit sh.a. Elbasan dhe me miratim të Drejtorit të Përgjithshëm, për arsye të riorganizimit të punës, punonjësi [] me detyrë shpërndarës pranë Zyrës Qendër Elbasan, ka kaluar agjent pranë Zyrës Postare Stravaj të Degës Librazhd.

Sipas shkresës në fjalë, kjo lëvizje u bë në kuadër të ristrukturimit dhe vlerësimit të dosjes individuale të punonjësit, i cili rezulton me arsim 8-vjeçar dhe nuk mund të vazhdojë të punojë në këtë detyrë me vlera monetare. Në bazë të këtij arsyetimi, transferimi i Z. [] nuk konsiderohet si veprim diskriminues ndaj tij, nga ana e Filialit të Postës Elbasan.

¹Neni 33, pika 7, i ligjit 10 221/2010, parashikon : "Me marrjen e ankesës, komisioneri verifikon faktet. Për këtë qëllim, komisioneri mund t'u kërkojë ankuesit dhe personit kundër të cilit është drejtuar ankesa, të paraqesin parashtrime me shkrim brenda 30 ditëve nga dita që palët marrin njoftimin. Kur e çmon të nevojshme, komisioneri merr informacione dhe nga çdo person ose burim tjetër".

- Në vijim të procedurave hetimore, referuar Urdhërit nr. 33, datë 12.02.2014 të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, “Për kryerjen e inspektimit pranë Filialit të Postës Elbasan, me qëllim kryerjen e verifikimeve mbi ankesën e Z. [emri], ekipi i inspektimit të KMD-së, në datën 25.02.2014, kreu inspektim pranë Filialit të Postës Elbasan.

Gjatë inspektimit, inspektorët e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, u takuan me Drejtoreshën² e Filialit të Postës Elbasan, Znj. [emri], e cila dha sqarimet përkatëse mbi çështjen objekt ankese.

Znj [emri] pyetet nga inspektorët lidhur me dy ankesat e Z. [emri], ndërkohë që ajo shpjegon arsyet e transferimit dhe largimit nga puna të ankuesit.

Kështu, sipas Drejtoreshës së Filialit të Postës Elbasan, menjëherë pas emërimit të saj në këtë detyrë, firma “Viktoria Invest” sh.p.k. kishte depozituar ankesë kundër shpërndarësit [emri], i cili nuk kishte dorëzuar në kohë një objekt postar pranë kësaj firme dhe si pasojë e vonesës, firma mund të kishte patur probleme. Këto të fundit janë shmangur, sepse Filiali i Postës Elbasan kishte lëshuar një vërtetim, ku vërtetohej që vonesa kishte ndodhur si pasojë e moskorrektësisë së punonjësit të tij, ndaj të cilit u mor edhe masa disiplinore “vërejtje me paralajmërim për pushim nga puna”. Kjo ishte një ndër arsyet pse Z. [emri] transferuar³ si agjent në Zyrën Postare Stravaj, Librazhd.

Por, sipas Drejtoreshës së Filialit të Postës Elbasan, arsyeja kryesore e transferimit të Z. [emri] nga detyra “shpërndarës” pranë këtij filiali, në detyrën “agjent” pranë Degës Stravaj, Librazhd, u krye si pasojë e ristrukturimit të institucionit. Znj. [emri] thekson faktin se pas transferimit, ai nuk është paraqitur asnjëherë në detyrën e re. Mosparaqitja në detyrën e re dhe mungesat e tij ishin shkak kryesor, i cili ka ndikuar në mënyrë të drejtpërdrejtë në largimin⁴ e tij nga puna.

Një arsye tjetër që Znj. [emri] rendit si shkak për transferimin e ankuesit, është edhe niveli i tij arsimor. Z. [emri] ka përfunduar arsimin 8-vjeçar, ndërkohë që në bazë të aktit **“Struktura organizative e degëve të kategorisë së parë te Posta Shqiptare sh.a. me pagat përkatëse sipas vendeve të punës dhe kategorive 2012”**, rezulton se për pozicionin “shpërndarës”, arsimi i mesëm është kriter për punësim.

Drejtoresha e Filialit të Postës Elbasan iu përgjigj pyetjeve të inspektorëve dhe theksoi faktin se pranë Filialit të Postës Elbasan nuk punonin më shpërndarës me arsim 8-vjeçar. Sipas saj të gjithë shpërndarësit me këtë arsimim, ishin zëvendësuar me punonjës me arsim të mesëm. Shpërndarësit me arsim 8-vjeçar ishin transferuar si agjentë pranë zyrave postare në periferi të qarkut Elbasan.

² Znj [emri] është emëruar në pozicionin e drejtoreshës së Filialit të Postës Elbasan në muajin tetor të vitit 2013.

³ Ankesa nr. 3, datë 13.01.2014, e Z. [emri].

⁴ Ankesa nr. 10, datë 05.02.2014, e Z. [emri].

Kështu për sa më sipër, nga punonjësja e Sektorit të Burimeve Njerëzore të Filialit të Postës Elbasan, inspektorët e Komisionerit u bënë me dije, se edhe 3 punonjës⁵ të tjerë me detyrë shpërndarës pranë këtij Filiali, të cilët kishin arsim 8-vjeçar, ishin transferuar në detyrën e agjentit pranë Zyrave Postare, në varësi të këtij Filiali. Ndaj tyre⁶, Drejtoresha e Filialit të Postës Elbasan kishte marrë masë disiplinore "largim nga puna" për shkak të mungesave të paarsyeshme në punë (sepse nuk ishin paraqitur në vendet e reja, të punës). Ndwrkohw, qw Z. wshtw larguar nga puna, por jo se nuk wshtw paraqitur nw detyrwn⁷ e tij tw re.

Znj. e mohon faktin se largimi nga puna i Z. është bërë për arsye diskriminuese, për shkak të përkatësisë së tij në komunitetin rom, përkundrazi ajo thekson se edhe shoferi i institucionit, i cili është emëruar rishtazi në këtë detyrë nga ana e saj, i përket këtij komuniteti.

Inspektorët e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi kërkuan të administronin të gjithë aktet e dosjes personale të ankuesit, si dhe të gjithë aktet, nëpërmjet të cilëve ai kishte marrë masa disiplinore, urdhërin e transferimit, largimit nga puna, listëprezencën e muajit janar 2014 etj.

Pas analizimit të akteve të sipërpërmendura, u konstatua se :

1. Nëpërmjet Urdhërit nr. 25, datë 09.01.2014, të Drejtoreshës së Filialit të Postës Elbasan, Z. është transferuar nga detyra e shpërndarësit pranë Filialit të Postës Elbasan, në detyrën e agjentit pranë Zyrës Postare Stravaj Librazhd

Ndërkohë, një ditë më vonë, me Urdhërin nr. 28/1, datë 10.01.2014, të Drejtoreshës së Filialit të Postës Elbasan, ai ka kaluar sërish në pozicionin e shpërndarësit pranë Filialit të Postës Elbasan. Rikthimi i tij në detyrën e mëparëshme, ishte fakt, i cili nuk kujtohej nga Drejtoresha e Filialit të Postës Elbasan, e cila më parë ishte shprehur⁸ se Z. ishte larguar nga detyra e agjentit në Zyrën Postare Stravaj, Librazhd, për shkak të mungesave në punë. Njëkohësisht, fakti që, Z. ka paraqitur ankesë pranë KMD-së në datën 13.01.2014, na bën të gëjojmë se as ai vetë në atë kohë, nuk kishte dijeni për rikthimin e tij në pozicionin e mëparshëm të punës.

Pas analizimit të listëprezencës së muajit Janar 2014, të Filialit të Postës Elbasan rezulton se Z. është paraqitur në punë pranë Filialit të Postës Elbasan, jo pranë Zyrës

⁵ Këta punonjës i përbasin komunitetit jo rom.

⁶ Z. dhe Z.

⁷ Sic rezulton nga analizimi i Urdhërit nr. 121, datë 28.01.2014, të Drejtoreshës së Filialit të Postës Elbasan, Z. është larguar nga puna me motivacionin "Bazuar në evidencat e Zyrave Postare, në të cilat nuk arrihet efektiviteti i duhur për mbarëvajtjen e ecurisë së Filialit, si dhe për arsye të mos realizimit të detyrave për vitin 2013, të paraqitura në auditimet e kryera gjatë vitit 2013 mbi problemet dhe mangësitë e konstatuara me shkresën nr. 23, datë 23.01.2014, të Drejtorisë së Auditimit".

⁸ Gjatë inspektimit pranë Filialit të Postës Elbasan është mbajtur procesverbal, i cili është nënshkruar nga palët e pranishme.

Postare Stravaj Librazhd, deri në datën 28.01.2014 dhe nuk ka kryer asnjë mungesë të paarsyeshme. Ky fakt bie sërish në kundërshtim me dëshminë e Znj. [] e cila theksoi faktin se një ndër arsyt kryesore të largimit të tij nga puna ishte numri i mungesave pa arsye, që ai kishte bërë pranë Zyrës Postare Stravaj Librazhd, ndërkohë që Z. [] nuk kishte asnjë arsye për t'u paraqitur në detyrën e re, sepse Urdhëri nr. 25, datë 09.01.2014, për transferimin e tij, ishte anuluar dhe nëpërmjet Urdhërit nr. 28/1, datë 10.01.2014, pra, ai ishte rikthyer në pozicionin e mëparshëm të punës.

Sërish, sipas shkresave të administruara, rezulton se vetëm 18 ditë më vonë, përkatësisht në datën 28.01.2014, Z. [] është larguar nga puna (nga detyra e shpërndarësit pranë FP Elbasan), nëpërmjet Urdhërit nr. 121, datë 28.01.2014, të Drejtoreshës së Filialit të Postës Elbasan.

Motivacioni i përshkruar në Urdhërin nr. 121, datë 28.01.2014 është : *“Bazuar në evidencat e Zyrave Postare, në të cilat nuk arrihet efektiviteti i duhur për mbarëvajtjen e ecurisë së Filialit, si dhe për arsye të mos realizimit të detyrave për vitin 2013, të paraqitura në auditimet e kryera gjatë vitit 2013 mbi problemet dhe mangësitë e konstatuara me shkresën nr. 23, datë 23.01.2014, të Drejtorisë së Auditimit”.*

Për sa më sipër, për të qartësuar motivacionin e largimit nga puna të Z. [], inspektorët e Komisionerit kërkuan të administronin një kopje të shkresës nr. 23, datë 23.01.2014 të Drejtorisë së Auditimit. Nga shqyrtimi që iu bë këtij raporti, u konstatua se emri i shpërndarësit [], nuk rezultonte në asnjë pjesë të këtij raporti, si punonjës, i cili kishte patur mangësi, probleme apo shkelje gjatë punës së tij. Njëkohësisht, referuar motivacionit të këtij urdhëri, nuk ekzistonte ndonjë akt tjetër i përmendur në të, ku të evidentohej ndonjë shkelje e Z. [].

Ndërkohë që, konstatohet se motivacioni i mosplotësimit të kriterit të arsimit të mesëm nuk është vënë as në Urdhërin nr. 28/1, datë 10.01.2014 të transferimit të Z. [] (i cili është anuluar nëpërmjet Urdhërit nr. 25, datë 09.01.2014, të Drejtoreshës së Filialit të Postës Elbasan) dhe as në Urdhërin nr. 121, datë 28.01.2014 për largimin e tij nga puna.

Në këtë mënyrë, rezulton se Urdhëri nr. 121, datë 28.01.2014, i Drejtoreshës së Filialit të Postës Elbasan, është mbështetur në motivacion të pabazuar në ligj apo në raporte auditimi.

3. Përveç sa më sipër, në nenin 15, pika 2, të ligjit nr.10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi” parashikohet : *“Gjatë periudhës së shqyrtimit të ankesës, punëmarrësi ka të drejtë të vazhdojë punën sipas kushteve të kontratës”.* Drejtoresha e Filialit të Postës Elbasan ka qënë në dijeni të faktit, që ankesa e Z. [] po shqyrtohej dhe hetohej nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, (nëpërmjet korrespondencës zyrtare me KMD-në) dhe pavarësisht kësaj ankuesi është larguar nga puna, gjë që sjell si pasojë shkeljen e parashikimit të këtij ligji.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenin 12, nenin 15, pika 2, nenin 21, pika 1, nenin 32, pika 1, gërma a), si dhe nenin 33, pikat 1, 3, 5, 7 dhe 10 të Ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

VENDOSI:

Konstatimin e mosdiskriminimit për shkak të racës, në fushën e punësimit, të Z. [Emri i fshehur], nga Filiali i Postës Elbasan, për arsye të transferimit të tij nga detyra e shpërndarësit pranë Filialit të Postës Elbasan, në detyrën e agentit pranë Zyrës Postare Stravaj Librazhd.

2. Konstatimin e diskriminimit për shkak të racës, në fushën e punësimit, të Z. Erion Bajrami, nga Filiali i Postës Elbasan, për arsye të largimit të tij nga puna.
3. Referuar pikës 2 të këtij Vendimi, rekomandohet marrja e masave të menjëherëshme nga Filiali i Postës Elbasan, për sistemin në punë të ankuesit.
4. Brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga marrja dijeni për këtë vendim, Filiali i Postës Elbasan të njoftojë Komisionerin, lidhur me masat e marra për zbatimin e këtij vendimi.
5. Në referim të nenit 33, pika 11, të ligjit nr. 10 221, datë 04. 02. 2011, “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, moszbatimi i këtij vendimi sjell si pasojë ndëshkimin me gjobë, sipas parashikimeve të bëra në pikën 13 të po këtij neni.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

